



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIC OF KOSOVA  
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E DEÇANIT  
MUNICIPALITY OF DEÇAN  
OPSTINA DEÇAN



Data e mbajtjes: 21.04.2026

## RAPORT PËR KONSULTIM PUBLIK Për Draft Rregulloren për Taksa Komunale

### Hyrje

Komuna e Deçan, në përputhje me parimet e transparencës dhe pjesëmarrjes qytetare në vendimmarrje, ka organizuar konsultimin publik lidhur me Draft Rregulloren për Taksa Komunale.

Njoftimi për mbajtjen e konsultimit publik, së bashku me Draft Rregulloren, është publikuar paraprakisht në ueb-faqen zyrtare të Komunës, duke u mundësuar qytetarëve dhe palëve të interesit që të informohen dhe të kontribuojnë me komente dhe sugjerime.

### Pjesëmarrja

Në këtë konsultim publik kanë marrë pjesë gjithsej 57 persona, prej të cilëve:

- 25 femra
- 32 meshkuj

Pjesëmarrësit përfshinin qytetarë, përfaqësues të bizneseve, organizatave të shoqërisë civile dhe zyrtarë komunalë.

### Përmbajtja e diskutimit

Gjatë takimit u prezantua Draft Rregullorja për Taksa Komunale, me theks të veçantë në strukturën e taksave, kategoritë përfituese, procedurat e pagesës dhe aspektet e zbatimit të saj. Pas prezantimit, u hap diskutimi ku pjesëmarrësit patën mundësi të shprehin qëndrimet, vërejtjet dhe propozimet e tyre.

### Rekomandimet e pranuar nga të pranishmit

Nga diskutimet e zhvilluara gjatë konsultimit publik, u evidentuan këto rekomandime kryesore:

1. Rishikimi i nivelit të disa taksave komunale me qëllim të lehtësimit të barrës financiare për qytetarët dhe bizneset e vogla.
2. Parashikimi i lehtësirave dhe përjashtimeve për kategoritë e ndjeshme sociale.
3. Rritja e transparencës lidhur me menaxhimin dhe shfrytëzimin e të hyrave nga taksat komunale.
4. Përmirësimi i informimit publik për obligimet dhe procedurat e pagesës.
5. Thjeshtësimi i procedurave administrative për pagesën e taksave komunale.

### **Përfundim**

Konsultimi publik u zhvillua në një atmosferë konstruktive dhe gjithëpërfshirëse. Komuna e Deçanit do t'i shqyrtojë të gjitha komentet dhe rekomandimet e pranuar gjatë këtij procesi, me qëllim të përmirësimit të Draft Rregullores për Taksa Komunale para miratimit të saj përfundimtar.

Zyra për Informim

*Ehem*

